
LAJME TË MIRA NGA

SUNDIMI I LIGJIT

RAPORTI TREMUJOR 12



FORCOHET BASHKËPUNIMI RAJONAL NË GJYQËSI NË KONFERENCËN VJETORE TË 16-TË TË KRYESUESVE TË GJYQËSORIT

PROMOVOHET BARAZIA DHE MOS-DISKRIMINIMI NË EKSPOZITËN E POSTERAVE PËRMES SYVE TË STUDENTËVE

NË EDICIONIN E TRETË TË BISEDAVE TË BARAZISË EKSPLOROHET DISKRIMINIMI ME BAZË GJINORE NË VENDIN E PUNËS

RRITJA E VETËDIJES MBI LOBIMIN: FUSHATA E REALIZUAR NË DISA KANALE PREK MBI 700 000 QYTETARË NË MBARË MAQEDONINË E VERIUT

EU SUPPORT FOR RULE OF LAW

GUSHT 2026

KY RAPORT U FINANCUA NGA BASHKIMI EVROPIAN. PËRMBAJTJA E TIJ ËSHTË PËRGJEGJËSI E VETME E LUDËIG BOLTZMANN GESELLSCHAFT - INSTITUTI I TË DREJTAVE THEMELORE DHE TË NJERIUT (LBI-GMR) DHE NUK PASQYRON DOMOSDOSHMËRISHT PIKËPAMJET E BASHKIMIT EVROPIAN.

Financuar nga
Bashkimi Evropian

PARATHËNIE



Diter SHINDLAUER

Udhëheqës Ekipi, Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit

"Po e shfrytëzojmë këtë botim që të vazhdojmë të mbajmë lartë moralin dhe etikën e besimit në një arsye të shëndoshë për ndryshim, reforma dhe proces të vazhdueshëm përmirësimi. Për të bërë këtë, do të flasim mbi hapat e bëra përpara dhe do të festojmë për to në mënyrë që të mos humbasin në lajmet jo aq pozitive që janë gjithmonë më të zëshme."

I dashur lexues,

Mirë se vjen në këtë botim të 12-të të ,,Lajmeve të mira nga sundimi i ligjit''. Në këtë botim theks i veçantë i jepet komunikimit, përfshirë këtu komunikimin strategjik, atë të drejtpërdrejtin, rritjen e vetëdijes, si dhe komunikimin përmes arteve pamore. Do të mund të mësoni më shumë për atë se si zyrtarë të lartë në fushën e gjyqësorit dhe udhëheqës të Gjykatës Supreme nga Evropa Qendrore dhe Lindore trajtojnë detyrat dhe sfidat me të cilat ballafaqohen. Mund të lexoni edhe diskutimet e ekspertëve mbi diskriminimin me bazë gjinore në vendin e punës dhe nevojën e madhe për të folur më shumë mbi këtë çështje, sidomos kur bëhet fjalë edhe për ngacmim seksual.

Veç kësaj, kur bëhet fjalë për të kuptuar më mirë rolin dhe punën që bën prokuroria, Prokuroria Publike miratoi strategjinë e re të komunikimit me të cilën do të ruhet informacioni i drejtë dhe proaktiv për opinionin. Komunikimi i drejtë është parakusht për rritjen e besimit tek institucionet, dhe besimi përbën një bazë të rëndësishme për funksionim të plotë dhe me ndikim të vetë institucionit. Pra, kjo strategji duhet të ndihmojë që të krijohet një cikël i drejtë i rritjes konstante të cilësisë së përbashkët.

Sa i përket rritjes së vetëdijes, mund t'ju flasim më shumë për fushatën që shpjegon konceptin dhe trajtimin e lobimit që jua prezantuam në botimin paraprak: Fushata online u ndoq nga mbi 700.000 persona gjithsej siç do e lexoni edhe vetë tek kapitulli më poshtë. Një numër mjaft i madh!

PARATHËNIE

Në këtë raport kemi përfshirë një qasje më ndryshe ndaj ngritjes së vetëdijes: bashkë me Komisionin për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Universitetin Evropian në Shkup, projekti ynë kërkoi nga studentët e Fakultetit të Artit dhe Dizajnit pranë Universitetit Evropian Shkup që të dizajnojnë postera që promovojnë barazinë dhe mos-diskriminimin. 25 nga këto vepra arti u ekspozuan me sukses në Galerinë OSTEN në Shkup. Këto postera mund t'i shijoni edhe si pjesë të këtij raporti.
Një hap tjetër drejt garancës që çështja e sigurimit të trajtimit të drejtë për të gjithë, sidomos për parandalim të diskriminimit, paragjykimeve dhe keqpërdorimit të forcës në policimin e përditshëm trajtohen në komunikim me forcat policore maqedonase është edhe trajnimi për 12 policë trajnerë. Në këtë drejtim, u fut në përdorim edhe një mjet i ri për mësim elektronik mbi të drejtat e njeriut bashkë me Ministrinë e Administratës Publike. Qëllimi është forcimi i njohurive dhe kapaciteteve të punonjësve së administratës publike për të zbatuar qasjet që kanë për bazë të drejtat e njeriut gjatë punës së tyre të përditshme.
Siç mund ta shihni edhe vetë në këtë raport, kemi biseduar, planifikuar, postuar dhe mësuar fortë bashkë me partnerët tanë gjatë një periudhe shumë të rëndësishme. Por edhe përkrah gjithë kësaj zhurme, si Projekt, nuk ndaluam kurrë së dëgjuari partnerët tanë në vend duke u përpjekur që gjithmonë t'iu përshtatemi nevojave të vërteta që ata kanë.

Shijoni lajmet e mira!



Dieter Schindlauer
Udhëheqës ekipi

JU PREZANTOJMË:

KONFERENCA E 16-TË VJETORE E UDHËHEQËSVE TË GJYQËSORIT FORCON BASHKËPUNIMIN RAJONAL TË GJYQËSORIT

Në këtë konferencë u bënë bashkë udhëheqësit e gjyqësorit dhe zëvendës kryetarët e gjykatave supreme nga 13 vende të rajonit, si dhe delegacioni gjyqësor nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për të këmbyer përvojat dhe për të diskutuar mbi sfidat e përbashkëta me të cilat përballet gjyqësori.

EKSPOZITA E POSTERAVE PROMOVON BARAZINË DHE MOS-DISKRIMINIMIN SIPAS SYVE TË STUDENTËVE

Në këtë ekspozitë u prezantuan 25 postera krijuar nga studentët e Fakultetit të Artit dhe Dizajnit pranë Universitetit Evropian në Shkup. Këto punime u realizuan pas një ligjerateje dhe diskutimi interaktiv me përfaqësues nga KMBD mbi barazinë, diskriminimin, të drejtat e njeriut dhe rolin që ka organi i barazisë.

EDICIONI I TRETË I BISEDAVE TË BARAZISË EKSPLORON DISKRIMINIMIN ME BAZË GJINORE NË VENDIN E PUNËS

Në këtë diskutim u theksuan sfidat me të cilat viktimat vazhdojnë të përballen gjatë raportimit të ngacmimit seksual duke nënvizuar rëndësinë që kanë mekanizmat me qasje dhe që kanë në qendër të vëmendjes viktimën, si dhe nevojën për të vazhduar forcimin dhe harmonizimin e kornizës ligjore për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi.

Të flasim pak për...

- Konferenca e 16-të vjetore e udhëheqësve të gjyqësorit forcon bashkëpunimin rajonal të gjyqësorit
- Vizita studimore në Ministrinë e Brendshme të Sllovenisë për të mbështetur bashkëpunimin ndërkombëtar policor
- Edicioni i tretë i Bisedave të Barazisë eksploron diskriminimin me bazë gjinore në vendin e punës
- Forcimi i Prokurorisë Publike përmes komunikimit strategjik dhe bashkëpunimit ndërkombëtar
- Rritja e vetëdijes mbi lobimin: Fushata në disa kanale informon mbi 700.000 qytetarë në mbarë Maqedoninë e Veriut
- Ekspozita e posterave promovon barazinë dhe mos-diskriminimin sipas syve të studentëve
- Vegla për studim elektronik mbi të drejtat e njeriut mbështet reformën në administratën publike

Konferenca e 16-të vjetore e udhëheqësve të gjyqësorit forcon bashkëpunimin rajonal të gjyqësorit

Projekti ,,Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit'' mbështeti Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë organizimit të Konferencës së 16 Vjetore të udhëheqësve të gjyqësorit nga Evropa Qendrore dhe Lindore, në bashkëpunim me Institutin CEELI më 22 dhe 23 qershor 2026. Në këtë konferencë u bënë bashkë shefat e gjyqësorit dhe zëvendës kryetarët e gjykatave supreme nga 13 gjyqësorë në rajon, si dhe një delegacion gjyqësor nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për të këmbyer përvoja dhe për të diskutuar mbi sfidat e përbashkëta me të cilat ballafaqohet gjyqësori.

Siç tha edhe Kryetari i Gjykatës Supreme, Z. Afrim Fidani në fjalën përshëndetëse:

> ,,Kjo konferencë paraqet një mundësi të çmuar për dialog të hapur, për këmbim përvojash, praktika të mira dhe ide, si dhe për reflektim të përbashkët mbi të ardhmen e gjyqësisë në Evropë. Forca që kanë gjykatat supreme nuk buron nga forca politike apo nga resurset që ato i disponojnë, por nga autoriteti i vendimeve që marrin dhe nga respekti që ia jep vetë roli i tyre kushtetues. Pikërisht për këtë arsye funksionimi i pavarur dhe efektiv i gjykatave supreme përbën një përgjegjësi të përbashkët të të gjitha institucioneve të vendit. Respekti ndaj gjyqësisë nuk ka të bëjë vetëm me çështjen institucionale; por është një parakusht thelbësor për rend stabil kushtetues. Gjykatat supreme nuk janë gjykatat më të larta ngaqë qëndrojnë më lartë se të gjitha degët e tjera të qeverisjes, por ngaqë janë organ i besuar me përgjegjësinë më të lartë—të sigurohen që sundimi i ligjit mbisundon çdo formë forceje, dhe shërben si një garancë definitive institucionale për mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut."

Në këtë konferencë u drejtuan me fjalë përshëndetëse edhe Z. Dejvid Kembell, Gjykatës i Lartë i Qarkut dhe Kryesues i Komisionit për Marrëdhënie Ndërkombëtare (Shtetet e Bashkuara), Z. Robert R. Strang, Drejtor Ekzekutiv i Institutit CEELI, dhe Gjykatës Gregor Borkovski nga projekti ,,Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit''. Të ftuar nderi në këtë konferencë ishin Presidentja e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Znj. Gordana Siljanovska-Davkova, dhe Kryetari i Këshillit Gjyqësor, Z. Aleksandar Kambovski.

Gjatë diskutimit në pjesën e punës fokusi ishte tek pavarësia, ndërtimi i besimit publik, zbatimi i vendimeve të Gjykatës Evropiane, komunikimet gjyqësore, dhe përdorimi i inteligjencës artificiale.

Projekti ynë vazhdon të marrë përsipër mbështetjen e iniciativave që forcojnë gjyqësinë e pavarur, transparente, dhe efikase si një nga gurthemelet e sundimit të ligjit.





Duke kapur suksesin:

Një festim vizual











Vizitë studimore në Ministrinë e Brendshme të Sllovenisë për të mbështetur bashkëpunimin ndërkombëtar policor

Vizita studimore në Ministrinë e Brendshme në Sllloveni (16–18 qershor 2026) u mundësoi përfaqësuesve të Policisë nga Republika e Maqedonisë të Veriut të mësojnë gjëra të vlefshme mbi mënyrën e organizimit dhe punës së Sektorit për Bashkëpunim Ndërkombëtar Policor në Sllloveni. Në këtë program fokusi ishte tek bashkëpunimi përmes Europolit, Interpolit, Byrosë SIRENE dhe hetimeve penale ndërkufitare, si dhe tek përdorimi i sistemeve për menaxhim me lëndët, Sistemit Shengen për Informacion, procedurat e ekstradimit dhe strukturat API/PNR.

Gjatë kësaj vizite, pjesëmarrësit këmbyen përvoja me kolegët e tyre sllovenë dhe bënë identifikim të disa praktikave të mira që do të mund të përshtateshin në sistemin maqedonas. Këtu bëjnë pjesë rritja e cilësisë së menaxhimit operativ me lëndët, forcimi i sistemeve të integruara të informacionit, dhe forcimi i procedurave për trajtim të kërkesave ndërkombëtare operative.

Në këtë vizitë studimore si përfundim dolën disa rekomandime për harmonizim të mëtejshëm të procedurave të vendit me standardet e BE-së, forcimi i kapaciteteve organizative, rritja e numrit të të punësuarve dhe vazhdim i zhvillimit të një sistemi bashkëkohor për menaxhim me lëndët brenda Ministrisë së Brendshme.

Edicioni i tretë i Bisedave për Barazi eksploron diskriminimin me baza gjinore brenda vendit të punës

Në 1 korrik 2026, projekti ynë në bashkëpunim me Komisionin e Parandalimit dhe Mbrojtjes kundër Diskriminimit (KPMD) organizoi edicionin e tretë të serisë Bisedat e Barazisë, që iu dedikua trajtimit të diskriminimit me baza gjinore brenda vendit të punës.

Në këtë ngjarje u bënë bashkë përfaqësues nga EQUINET, organet e barazisë së Maqedonisë së Veriut dhe Austrisë, gjyqësori, akademia, ministritë relevante, inspektoratet e punës, sindikatat dhe organizatat civile për të këmbyer njohuri dhe praktika pozitive dhe për të diskutuar mbi mënyra efektive për t'iu përgjigjur diskriminimit me bazë gjinore, ngacmimit seksual brenda vendit të punës dhe pagesës së barabartë për punë të barabartë.

Në këtë diskutim u theksuan sfidat më të cilat vazhdojnë të ballafaqohen viktimat gjatë raportimit të ngacmimit seksual, duke nënvizuar rëndësinë e mekanizmave mbrojtëse me qasje të lehtë dhe që kanë në qendër të vëmendjes viktimën si dhe nevojën për të vazhduar forcimin dhe harmonizmin e kornizës ligjore për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi.



Poashtu pjesëmarrësit theksuan që të ushqyerit e një vendi pune të sigurt, përfshirës dhe me respekt nuk ka të bëjë vetëm me mbrojtjen e të drejtave themelore por sjell përfitime edhe për punëdhënësit. Mjediset e punës që bazohen në barazi dhe respekt kontribojnë në kënaqësi më të madhe tek të punësuarit dhe qëndrim në vendin e punës, ulin kostot e punësimeve dhe trajnimeve të reja, ruajnë njohurinë institucionale, dhe ulin rrezikun e procedurave të gjata dhe të kushtueshme ligjore.

Poashtu në këtë ngjarje u nënvizua rëndësia që ka veprimi i koordinuar mes institucioneve, punëdhënësve dhe partnerëve socialë në avancimin e barazisë brenda vendit të punës. Pjesëmarrësit ranë dakord që arritja e mundësive të barabarta dhe të siguruarit që mundi i secilit shihet dhe vlerësohet në mënyrë të barabartë, pa dallim gjinie, kërkon në mënyrë të vazhdueshme bashkëpunim, ngritje të vetëdijes dhe zhvillim politikash.

,,Bisedat e barazisë'' vazhdon të shërbejë si platformë dialogu, këmbimi përvojash dhe promovim të politikave anti-diskriminuese. Projekti i BE-së për sundim të ligjit dhe KMPD falenderojnë të gjithë prezantuesit dhe pjesëmarrësit për kontributin e tyre në këtë diskutim të rëndësishëm dhe presin me padurim të vazhdojnë këtë sërë bisedash gjatë vitit 2027.





Forcimi i Prokurorisë Publike përmes komunikimit strategjik dhe bashkëpunimit ndërkombëtar

Si pjesë e konferencës ,,Nga strategjia në zbatim: Forcimi i komunikimit të Zyrës së Prokurorisë Publike me publikun'', organizuar nga Zyra e Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut bashkë me projektin tonë në 3 qershor 2026, u prezantuan zyrtarisht Strategjia e re e Komunikimit dhe identiteti i ri vizuel i këtij institucioni.

Strategjia e Komunikimit u përpilua në bashkëpunim me ekspertët nga Komponenti 1 i projektit ,,Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit''. Pas miratimit nga Zyra e Prokurorisë Publike, zbatimi i Strategjisë filloi me prezantimin e logos së re të këtij institucioni. Logoja me dizajn të ri përfshin edhe simbolet evropiane dhe pasqyron angazhimet që institucioni ka marrë për të respektuar vlerat evropiane dhe aspiratat për të arritur standardet evropiane dhe sundim të ligjit.



Në këtë konferencë u bënë bashkë përfaqësues nga Zyra e Prokurorisë Publike, Shoqata e Prokurorëve Publike, Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë, dhe profesionistë nga mediumet. Prezantime të veçanta mbajtën Z. Paulo Jorge Vieira Morgado de Karvalo, Zëvendës Prokuror i Përgjithshëm i Portugalisë, dhe Z. David Aleksandrino Paulo Albukerke e Aguilar, Këshilltar i Lartë i Prokurorit të Përgjithshëm në Republikën e Portugalisë, të cilët ndanë standardet ndërkombëtare dhe përvojat praktike mbi komunikimin e prokurorisë publike, duke ofruar praktikat e Shërbimit portugez të Prokurorisë Publike.

Vetëm një ditë para kësaj konference u bë një hap i rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit prokurorial me nënshkrim të Memorandumit për Bashkëpunim mes Zyrës së Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Zyrës së Prokurorisë Publike të Republikës së Portugalisë. Ky Memorandum vjen si rezultat i bashkëpunimit të arritur gjatë vizitës studimore në Portugali nga përfaqësuesit e Zyrës së Prokurorisë Publike të Maqedonisë së Veriut, organizuar me mbështetje të projektit të BE-së për sundim të ligjit.

Përgatitja dhe organizimi i nënshkrimit të këtij dokumenti kaq të rëndësishëm, me të cilin forcohet bashkëpunimi mes shërbimeve të prokurorisë në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit, krimit kibernetik, trafikimit të njerëzve, të drogës dhe larjes së parave, si dhe në këmbim përvojash mbi ndërtimin e kapaciteteve institucionale, u mbështet nga ekspertët e Komponentit të 1 të projektit të BE-së ,,Mbështetja për sundimin e ligjit''.

Me këtë Memorandum parashihen vizita studimore dhe vizita pune mes shërbimeve të prokurorisë të dy vendeve, këmbim i drejtpërdrejtë përvojash dhe praktikash pozitive në menaxhimin organizativ, menaxhimin me burimet njerëzore dhe teknologjitë digjitale, si dhe programe të përbashkëta trajnimi, seminare, konferenca, dhe punëtori për prokurorët në fusha të specializuara. Poashtu parashihen këmbime të të dhënave teknike, ekspertizës, dhe përvojave operative mes njësive të specializuara të prokurorive.



Duke kapur suksesin:

Një festim vizual









Rritja e vetëdijes mbi lobimin: Fushata në disa kanale informoi mbi 700 000 qytetarë në mbarë Maqedoninë e Veriut

Nga 7 prilli deri në 5 maj të vitit 2026, projekti i financuar nga BE-ja ,,Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit'' në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit (KSHPK), realizoi fushatë të gjerë për rritje të vetëdijes publike mbi lobimin në Maqedoninë e Veriut. Në këtë fushatë u kombinua informimi digjital me angazhimin e drejtpërdrejtë të palëve relevante në mënyrë që të demistifikohet lobimi, të shpjegohet korniza ligjore, dhe të promovohet transparenca dhe integriteti në vendimmarrjen demokratike.

Lobimi shpesh keqkuptohet në qeverisjen e Maqedonisë së Veriut. Për të trajtuar këtë zbrazëtirë, kjo fushatë përdori qasjen në disa nivele: në një video të animuar u bë shpjegimi i asaj se ç'është lobimi, si funksionon, dhe pse është i rëndësishëm; fletushka me informacione thjeshtëzuan dispozitat relevante ligjore dhe nënvizuan të drejtat dhe detyrimet e secilës palë; dhe reklamat digjitale në Meta dhe Google Display Network (GDN) përhapën mesazhin në publikun e gjerë në mbarë vendin.

Ky komponent digjital i fushatës zgjati nga 7 deri në 28 prill 2026 në dy platforma, duke dhënë rezultate të mira. Vetëm fushata në Meta informoi mbi 717 000 përdorues të vetëm, duke gjeneruar mbi 3.3 milionë impresione, dhe regjistroi mbi 71 000 angazhime në post dhe 5 500 klikime. Poashtu, fushata në GDN rezultoi me mbi 1 milionë impresione të tejra dhe 1 282 klikime, duke bërë që totali të arrijë numrin e mbi 4.4 milionë impresioneve në që të dy platformat. Kjo fushatë arriti vizibilitet në mbarë vendin, me performanca më të forta në Shkup, Ohër, Tetovë, Kumanovë, Manastir, Prilep, dhe qendra të tjera rajonale urbane, duke dëshmuar që shtrirja nuk ishte vetëm në kryeqytet.

Këto dy platforma plotësojnë njëra tjetrën në mënyrë efektive sa i përket mbulesës së audiencës. Meta performoi më fuqishëm mes publikut të moshës mes 25 dhe 34, që përbën 25% të audiencës së informuar. Fushata në GDN u ndoq më shumë nga publiku më në moshë, me grupmoshën 65+ si mosha me normën më të lartë të klikimeve. Këto dy kanale bashkë siguruan që mesazhi i fushatës të bëhet i dukshëm për të gjitha grupmoshat, gjinitë, dhe zonat gjeografike në mbarë vendin.

Përveç fushatës digjitale u organizuan katër tryeza të rrumbullakëta për të angazhuar palët relevante në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe për të lehtësuar dialog të strukturuar mbi rregullimin e lobimit dhe standardeve të integritetit. E para që u mbajt në 16 prill, bëri bashkë përfaqësues të KSHPK dhe komunitetit të biznesit. E dyta, në 20 prill vuri në fokus institucionet e qeverisjes qendrore. E treta, në 28 prill angazhoi përfaqësues të qeverisjes lokale,dhe e katërta, në 5 maj, bëri bashkë organizatat e shoqërisë civile dhe mediet. Gjithsej, 73 përfaqësues nga institucionet e niveleve qendrore dhe lokale, bizneset, shoqëria civile dhe mediet morën pjesë në diskutime me qëllime të qarta mbi rolet e tyre të veçanta dhe detyrimet brenda procesit të lobimit.



> “Me këtë fushatë shënohet një hap i rëndësishëm në përpjekjet tona për të ndërtuar kulturë transparence mbi lobimin në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Duke informuar qytetarët në mbarë vendin dhe duke bërë bashkë palët relevante, kontribojmë që të krijohen kushtet që lobimi të kuptohet, të praktikohet, dhe të rregullohet sipas standardeve më të larta demokratike dhe të integritetit,” tha Adem Çuçul, Kryetar i Komisionit Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit.


Me këtë fushatë u arrit suksesshëm vizibilitet i madh mbi komunikimin që ka të bëjë me lobimin në Maqedoninë e Veriut dhe u krijua platformë domethënëse për dialog mes KSHPK dhe komuniteteve të palëve relevante. Duke kombinuar shtrirjen e gjerë të kanaleve digjitale me thellësinë e angazhimit të drejpërdrejtë, kjo iniciativë bëri që të forcohet vetëdija mbi rregullimin e lobimit, transparencën, dhe llogaridhënien, dhe u vendos një bazë e mirë për aktivitetet e ardhshme për rritje të vetëdijes në këtë fushë.



Ekspozita e posterave promovon barazinë dhe mos-diskriminimin sipas syrit të studentëve

Në 19 maj 2026, Komisioni për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi (KPMD), Universiteti Evropian Shkup dhe Projekti i BE-së për sundimin e ligjit hapën ekspozitën e posterave për promovim të barazisë dhe mos-diskriminimit në Galerinë OSTEN në Shkup.

Në këtë ekspozitë u shfaqën 25 postera krijuar nga studentët e Fakultetit të Artit dhe Dizajnit pranë Universitetit Evropian Shkup. Këto vepra arti u dizajnuan pas një ligjerateje dhe diskutimi interaktiv me përfaqësuesit e KPMD mbi barazinë, diskriminimin, të drejtat e njeriut dhe rolin që ka organi për mbrojtjen e barazisë. Të frymëzuar nga kjo temë, studentët dorëzuan gjithsej 45 postera, nga të cilët 25 u zgjodhën për tu ekspozuar.



Përmes punës së tyre krijuese, studentët eksploruan temat siç janë barazia, respekti ndaj shumëllojshmërisë, përfshirja dhe e drejta për të jetuar jetë pa diskriminim. Posterat e tyre ofruan pikëpamje ndryshe mbi të drejtat e njeriut dhe dëshmuan se arti mund të frymëzojë një dialog dhe të nxisë ndryshime në shoqëri.

Në hapje morën pjesë mbi 50 vizitorë, duke e shndërruar galerinë në vend për diskutim, kreativitet dhe rritje të vetëdijes mbi rëndësinë që kanë barazia dhe mos-diskriminimi.

Pjesëmarrësit përshkruan këtë iniciativë si përvojë të çmuar mësimi që iu ka ndihmuar të kuptojnë më mirë diskriminimin dhe rolin që ka KPMD në mbrojtjen e të drejtave të barabarta. Ata theksuan që kombinimi i ligjeratave dhe të shprehurit krijues i ka inkurajuar të mendojnë mbi format e përditshme të diskriminimit dhe të komunikojnë mesazhet e tyre përmes artit pamor. Shumë nga ta poashtu përshëndetën mundësinë për të prezantuar veprat e tyre në publik duke kontribuar kështu në promovim të barazisë përmes artit.

Me këtë ekspozitë u dëshmua se si arti mund të shërbejë si një mjet i fuqishëm për të promovuar barazinë, për të inkurajuar dialogun dhe për të rritur vetëdijen mbi rëndësinë që ka mos-diskriminimi.










DIVERSITY
MAKES US STRONGER


Универзална декларација за човековите права
Член 23
„Секој, без каква и да е дискриминација,
има право на еднаква плата за иста работа“


@reallygreatsite
ГЛУВИ УШИ И ПРАЗНИ ЗБОРОВИ НЕ НОСАТ ПРАВДА


THIS IS NOT SUPPOSED TO E
A ROLLER COASTE
THE 5° ANGLE IS A HUMAN RIGHT


КОГА УСЛОВИТЕ СЕ РАЗЛИЧНИ,
РЕЗУЛТАТИТЕ НЕ СЕ ПРАВИЧНИ


TRAUMA
IS
NOT
COUTURE


РАЗЛИЧНОСТИТЕ НЕ ПРАВАТ ПОСИЛНИ
Различноста е бец на гордоста


ПРЕСМЕТКА НА МОЖНОСТИ
ТАЛЕНТИРАНА УЧЕНИЧКА
СПОРЕДНИ КРИТЕРИУМИ:
Талент за глума ✓
Изразување ✓
Вокабулар ✓
Талент за пеење ✓
Посветеност ✓
Желба ✓
ГЛАВЕН КРИТЕРИУМ:
Дали родителите се во истата политичка партија со учителката X
ЗАКЛУЧОК: МОЖЕ ДА СЕ ДОБИЕ САМО СПОРЕДНА УЛОГА
ВО НОРМАЛНИ УСЛОВИ ТАЛЕНТОТ БИ БИЛ ДОВОЛЕН.
#стопзанеправдаобразование #стопзадискриминација
mell.



WE
ARE
ALL



Надежта е
светлина против
дискриминацијата


ОДБЕРИ
ЕДНО!
А која сум јас?


WE ARE HIRING
NO OLDER THAN 28!
WEIGHT 60KG MAX!
SINGLE/ NO
MARRIED YE
MINIMUM HEIGHT 170CM
ETHNIC / CULTU
RELIGION
@reallygr
JUST NOT YOU!


ОВА НЕ Е
ИГРА
СТОП ЗА НАСИЛСТВОТО ВРЗ ЖЕНИТЕ


„Треба малку да се средиш.“
„Стави малце повеќе филтер, ова не ти личи“
„Си се запуштила.“
„Вака изгледаш уморно.“
„Зошто не го покриеш тоа?“


Нежноста не значи слабост
Не дискриминирај!


Freedom lives within,
and no one
can take that away from you.


FARKLI ELLER
AYNI UMUT
Ayrımcılığa karşı birlikte



ЧОВЕК







Нашата вредност не е во туѓите зборови









Vegla për studim elektronik mbi të drejtat e njeriut mbështet reformën në administratën publike


Projekti i BE-së për sundim të ligjit, financuar nga Bashkimi Evropian ka përpiluar një vegël të re për mësim elektronik mbi të drejtat e njeriut që ka për qëllim forcim të njohurive dhe kapaciteteve për punonjësit e administratës publike për të zbatuar qasje që kanë për bazë të drejtat e njeriut gjatë punës së tyre të përditshme.

Ky kurs online filloi zyrtarisht gjatë një ngjarjeje ku Ministria e Administratës Publike dhe Projekti i BE-së për sundimin e ligjit nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit, duke vendosur kështu bashkëpunim për promovim të trajnimeve mbi te drejtat e njeriut dhe forcim të mundësive për zhvillim profesional për zyrtarët publikë.

Kjo platformë për mësim elektronik do të integrohet brenda Sistemit të Ministrisë për Menaxhim me Mësimet (LMS), duke iu ofruar punonjësve të administratës mundësi me qasje dhe të vazhdueshme për të mësuar mbi parimet themelore të të drejtave të njeriut, përfshirë këtu barazinë, mos-diskriminimin, llogaridhënien dhe respektin e dinjitetit njerëzor.

Në këtë ngjarje u bënë bashkë përfaqësues nga Ministria e Administratës Publike, Bashkimit Evropian dhe Projektit të BE-së për sundimin e ligjit, duke theksuar angazhimet e përbashkëta për ndërtim të një administrate publike profesionale dhe që ka në qendër qytetarin kur respektimi i të drejtave të njeriut është pjesë përbërëse e kulturës institucionale dhe punës së përditshme.





Në fjalën e rastit, Ministri i Administratës Publike Goran Minçev theksoi që cilësia e administratës publike nuk matet vetëm me rregullativat që zbaton, por edhe me besimin që ka nga qytetarët.

> “Besimi në institucione ndërtohet kur qytetarët e ndjejnë që sistemi ua respekton të drejtat, vepron drejtë dhe siguron trajtim të barabartë për të gjithë. Prandaj njohuria, profesionalizmi dhe përgjegjësia e punonjësve të administratës janë thelbësore për funksionim të drejtë të një shoqërie demokratike,” tha Ministri Minçev.

Ai vazhdoi duke theksuar që reforma në administratën publike kërkon më shumë se ndryshime ligjore, ngaqë duhet edhe krijimi i një kulture të mësimit të vazhdueshëm, zhvillimi profesional dhe forcim të kapaciteteve institucionale.

Ambasadori i BE-së Mikalis Rokas theksoi rëndësinë e integrimit të parimeve të të drejtave të njeriut në reformën e administratës publike dhe rolin që ka kjo vegël e re në forcimin e kapaciteteve të punonjësve publikë.

> “Respektimi i të drejtave të njeriut ka një rol thelbësor në reformën e administratës publike. Kjo vegël elektronike e mbështetur nga BE-ja ka për qëllim të forcojë bashkëpunimin dhe të rrisë kapacitetet e zyrtarëve publikë për të zbatuar në praktikë qasjet që kanë në qendër të drejtat e njeriut,” tha Ambasadori i BE-së Mikalis Rokas.

Përpiluar me mbështetje të projektit të BE-së për sundim të ligjit, kjo vegël eletronike për mësim përbën një burim praktik për të përfshirë parimet e të drejtave të njeriut në punën e përditshme të institucioneve publike. Përmes përmbajtjeve interaktive dhe shembujve praktikë, me këtë platformë do të mbështeten punonjësit civilë për të kuptuar dhe zbatuar më mirë standardet e të drejtave të njeriut duke kontribuar për shërbime publike që janë më llogaridhënëse, më gjithëpërfshirëse dhe më të fokusuara tek qytetari.

Kjo iniciativë përbën një kontribut drejt qëllimeve të Strategjisë së Reformës në Administratën Publike 2023–2030 dhe pasqyron përpjekjet e vazhdueshme për ndërtim të institucioneve që funksionojnë në mënyrë profesionale, transparente dhe në shërbim të qytetarëve, duke respektuar të drejtat e njeriut si element thelbësor i funksionimit të tyre.



GUSHT - NËNTOR 2026

KALENDARI NGJARJET E ARDHSHME

SHTAT

Punëtori me Këshillin e Prokurorëve Publikë për procedurat diciplinoreж

Komponenti 1

SHTAT

Konferencë për prezantim të Strategjisë për Burimet Njerëzore për ZPB

Komponenti 1

25 - 27 GUSHT

Mbështetje për GP KSHPK gjatë finalizimit të aktit të sistematizimit

Komponenti 3

10 - 11 SHTAT

Vizitë studimore në Komisionin e Sllovenisë për Parandalim të Korrupsionit (CPC)

Komponenti 3

SHTAT

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Krimin Kibernetik për MPB (2026-2030)

Komponenti 2

SHTAT

Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit mbi Krimin e Organizuar (2026-2030)

Komponenti 2

30 SHTAT

Forumi i të Drejtave të Njeriut për të Drejtat e Fëmijëve

Komponenti 4

30 SHTAT

Grupi i punës i ekspertëve nga institucione të ndryshme në Shtip për forcim të ekipeve multisektorale

Komponenti 4

IMPRINT

Botues: Ludwig Boltzmann Gesellschaft - Instituti i të Drejtave Themelore dhe të Njeriut (LBI-GMR), Vjenë, në kuadër të Projektit ,,Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit", Shkup
Redaktoi: Kristina Vesiq
Lektura: Ane Petrushevska
Periudha e raportimit: 8 maj - 7 gusht 2026
Data: 7 gusht 2026

Financuar nga Bashkimi Evropian